



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
IDENTITEK SHA
DIVIZIONI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Data 16.02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “AUDITIM I BRENDSHËM I ISMS SIPAS STANDARDIT ISO 27001:2022”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT CPV- 72800000-8
– (Auditimi kompjuterik dhe shërbimet e testimit)

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,733,333 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor IdentiTek Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 9

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
 - b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon stafit të kualifikuar për realizimin e këtij shërbimi si më poshtë:

Minimumi 1 (një) Ekspert/ Drejtues Ekipi i cili të jetë i certifikuar si **ISO 27001:2022 “Lead Auditor”** ose **Lead Implementer/ ose ekuivalente** me të, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (në gjuhën shqipe ose të përkthyer/noterizuar);

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomën përkatëse
- Kontratën e punës e vleshme
- CV përkatëse
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standartet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjisacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Argumentim teknik: Operatori ekonomik duhet të dëshmojë kompetencën dhe certifikimi si Lead Auditor demonstroi aftësitë e tij për të planifikuar, kryer dhe raportuar auditime të plota të SMSI duke mbuluar rreziqe dhe procese thelbësore për një audit të brendshëm efektiv.

Pa këto kompetenca auditit i brendshëm rrezikon të mos jetë i mjaftueshëm duke rrezikuar kështu certifikimin e jashtëm apo moszbatim të Klauzolës 7.2 të ISO27001:2022 (kompetenca). Certifikimi si Lead Auditor është praktike standarde e organizatave për të dokumentuar kompetencat si auditues i brendshëm.

Kriteri teknik i percaktuar sipas pikes 2 të ”Kapacitetit Teknik” është hartuar nga Z.Renis Prifti, në cilësinë e specialistit të fushës në njësinë e prokurimit.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 30.03.2026 Ora:12:00

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.